



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13469 Prot

Lezhë, më 29 / 07 /2022

**VENDIM**

Nr. 85, Datë 28 . 07 .2022

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE TË SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE  
BUXHETORE PËR PBA-në 2023-2025 (Faza e dytë) TË BASHKISË LEZHË.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; dhe në zbatim të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**Vendosi :**

- 1.Miratimin e Tavaneve të Shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2023-2025 (për fazën e dytë) të Bashkisë Lezhë, sipas formularit të paraqitur dhe relacionit përkatës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
*Drejtoria e Buxhetit dhe Financës*

**RELACION**

**Mbi përgatitjen e Tavanëve sipas Programeve Buxhetore për PBA-në 2023-2025 të Bashkisë Lezhë (Faza e dytë).**

Të nderuar këshilltarë!

Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit ka përgatitur projekt/dokumentin për tavanet e shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2023-2025 për fazën e dytë, në mënyrë analitike dhe të strukturuar, bazuar në kërkesat e ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.7, datë 25.02.2022 dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”.

Projekt/dokumenti i tavanëve të PBA-së paraqet një prezantim të programeve buxhetore dhe nivelin e shpenzimeve sipas grup strukturës ekonomike, ku mundëson realizimin e funksioneve të veta dhe të deleguara. Projekt/dokumenti i tavanëve të PBA-së jep një informacion për programet dhe financimin e tyre për tre vitet e ardhshme 2023-2025. Në këtë projekt/dokument paraqitet në mënyrë të detajuar plani financiar i të ardhurave dhe shpenzimeve për tre vitet e ardhshme, sipas programeve.

Në këtë fazë të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, e cila është faza teknike, merret vendimi në nivel teknik dhe buxhetor, për tavane të qëndrueshme, të bazuar në politikat e zhvillimit, të cilat duhen respektuar gjatë fazës finale.

Për përcaktimin e tavanëve janë marrë në konsideratë të dhënat e shpenzimeve të realizuara e të parashikuara për periudhën 3 vjeçare 2020-2022, të dhënat mbi të ardhurat që krijohen nga burimet e veta (taksat e tarifat), transfertat nga burimet qendrore, politikat e zhvillimit për çdo program dhe zbatimi i objektivave strategjike të miratuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor.

Bazuar në raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave ven-

dore, në transfertat e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për bashkinë Lezhë dhe në transfertat e kuzhtëzuara që jepen nga Qeveria Qëndrore, rezulton se burimet (të ardhurat) dhe shpenzimet janë për tre vitet e ardhshme 2023-2025 si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Sipas viteve		
		2023	2024	2025
<b>I</b>	<b>BURIMET GJITHSEJ</b>	<b>2,203,660</b>	<b>2,356,930</b>	<b>2,358,387</b>
<b>I.a</b>	<b>Nga Burimet e Veta</b>	<b>777,268</b>	<b>814,591</b>	<b>820,262</b>
1	Të ardhurat vendore	777,268	814,591	820,262
<b>I.b</b>	<b>Nga Burimet Qëndrore</b>	<b>1,426,392</b>	<b>1,542,339</b>	<b>1,538,125</b>
1	Transferta e Pakushtëzuar	363,651	387,659	413,514
2	Transferta Sektoriale	236,806	240,994	243,404
3	Transferta e Kushtëzuar	625,849	651,102	671,207
4	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve	200,086	262,584	210,000
<b>II</b>	<b>SHPENZIMET GJITHSEJ</b>	<b>2,203,660</b>	<b>2,356,930</b>	<b>2,358,387</b>
<b>II.a</b>	Shpenzimet për Tavanet Buxhetore	2,189,983	2,341,457	2,342,187
<b>II.b</b>	Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës	13,677	15,473	16,200

☞ Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore për tre vitet e ardhshme janë pasqyruar në përputhje me të dhënat e miratuara nga këshilli bashkiak me vendimin nr.17, datë 28.02.2022. Për vitin 2023 parashikohet një rritje e të ardhurave rreth 5 % në krahasim me vitin 2022; për vitin 2024 parashikohet një rritje e të ardhurave rreth 4.<sup>8</sup> % në krahasim me vitin 2023 dhe për vitin 2025 parashikohet një rritje e të ardhurave 0.<sup>7</sup> % në krahasim me vitin 2024.

☞ Transferta e Pakushtëzuar për vitin 2023 parashikohet me një rritje rreth 6.<sup>8</sup> % në krahasim me vitin 2022, për vitin 2024 parashikohet me një rritje 6.<sup>6</sup> % në krahasim me vitin 2023, dhe për vitin 2025 parashikohet me një rritje 6.<sup>7</sup> % në krahasim me vitin 2024.

☞ Transferta sektoriale ndër vite është parashikuar me rritje nga viti në vit, respektivisht : në vitin 2023 - 1.<sup>1</sup> %, në vitin 2024 - 1.<sup>8</sup> % dhe në vitin 2025 – 1 %.

☞ Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën 2023-2025 janë parashikuar bazuar në udhëzimin e MFE nr.23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”, dhe në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2023-2025.

☞ Transferta e kushtëzuar, ku përfshihen fondet për Nd.Ekonomike, PAK, Gjendjen Civile, QKB etj janë parashikuar sipas politikave sektoriale ndër vite, të cilat rriten nga viti në vit nga 3 deri 4 %. Këto fonde jepen nga pushteti qendror.

☞ Krahas transfertës pashkushtëzuar, sektoriale dhe të kushtëzuar për bashkinë Lezhë janë parashikuar fonde për zbatimin e projekteve në vazhdim respektivisht : për vitin 2023-200,086 mijë lekë, për vitin 2024-262,584 mijë lekë dhe vitin 2025-210,000 mijë lekë, fonde të cilat do të financojnë ndërtimin e ujësjellsave në fshatrat Zejmen, Tresh Pllanë, Markatomaj e Spiten në Njësinë Administrative Zejmen dhe ndërtimin e ujësjellsit në zonën bregdetare të Njësisë Administrative Shënkoll.

Në përcaktimin e taveve përgatitore është përdorur metodologjia e buxhetimit mbi bazë programi dhe performance (BPP) duke siguruar lidhje midis burimeve publike (input-ve), produkteve, rezultateve mbi bazën e politikave dhe objektivave për çdo program buxhetor, si dhe kostove për çdo aktivitet.

Projekt/dokumenti i taveve buxhetore bën pasqyrimin e shpenzimeve për 9 fushat kryesore dhe për 18 programe të miratuar nga GMS-ja, ku nga 17 nënfunksiione gjithsej financohen 16 prej tyre dhe nga 20 programe gjithsej financohen 18 prej tyre.

Respektivisht jepen të dhënat në vlerë dhe përqindje për programet buxhetore:

Kod Progr.	Programi	2023		2024		2025	
		Në vlerë	Në % / totalit	Në vlerë	Në % / totalit	Në vlerë	Në % / totalit
01110	Planifikim, menaxhim,administrim	183,518	8.4	177,441	7.6	179,751	7.7
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	17,112	0.8	17,308	0.7	17,510	0.7
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe Civile	84,475	3.8	75,253	3.2	75,839	3.2
04130	Çështje ekonomike dhe tregtare	10,360	0.5	160,466	6.9	10,575	0.4
04220	Shërbimet Bujqësore	24,282	1.1	24,501	1.0	24,942	1.1
04240	Menaxhimi i Ujitjes dhe Kullimit	43,131	2.0	36,772	1.6	36,854	1.6
04260	Administrimi i Pyjeve e Kullotave	42,453	1.9	15,836	0.7	17,129	0.7
04520	Rrjeti Rrugor rural	346,895	15.8	282,318	12.1	176,578	7.5
04570	Transporti Publik	0	0.0	0	0.0	0	0.0
05100	Menaxhimi i Mbetjeve e Mjedisit	108,819	5.0	109,079	4.6	149,349	6.4
06140	Planifikimi Urban Vendor	17,425	0.8	17,581	0.8	17,898	0.8
06260	Shërbimet Publike Vendore	68,569	3.1	68,740	2.9	69,548	3.0
06370	Furnizime me Ujë dhe Kanalizime	211,982	9.7	274,716	11.7	222,375	9.5
07200	Shërbimi i Kujdesit Parësor	0	0.0	0	0.0	0	0.0
08130	Sport dhe Argëtim	17,255	0.8	82,236	3.5	43,704	1.9
08220	Trashegimia Kulturore e Eventet	38,776	1.8	59,156	2.5	22,882	1.0
09120	Arsimi Bazë dhe Parashkollor	240,606	11.0	198,187	8.5	285,740	12.2
09230	Arsimi i Mesëm	47,483	2.1	49,797	2.1	76,061	3.2
10430	Përkujdesi Social	680,992	31.1	686,216	29.3	909,594	38.8
10661	Strehimi Social	5,850	0.3	5,854	0.3	5,858	0.3
	<b>TOTALI</b>	<b>2,189,983</b>	<b>100.0</b>	<b>2,341,457</b>	<b>100.0</b>	<b>2,342,187</b>	<b>100.0</b>

Është bërë parashikimi i shpenzimeve për investime, ku përcaktimi i tyre është bazuar në dokumentat strategjikë të bashkisë, si: PPV, Strategjitë e Zhvillimit Sektoriale, prioritetet e miratuara, si dhe duke respektuar kriteret prioritare dhe rregullat bazë për financimin e tyre.

Në lidhje me përcaktimin e taveve përgatitore të PBA 2023-2025 për fazën e II-të, janë mbajtur parasysh edhe këto kritere bazë, si;

- ☞ Angazhimet buxhetore, ku përfshihen të gjitha shpenzimet për kontratat e lidhur, siç janë shpenzimet për pastrimin, për ushqimet dhe investimet në proces, etj.
- ☞ Kërkesat shtesë të bëra në fazën e parë, e konkretisht : për programin ‘04240’ “Ujitja e kullimi” janë shtuar fondet për vitin 2023 në shumën 6,501 mijë lekë investi-

me për ujitjen e kullimin; për programin '04260' "Administrimi i Pyjeve e Kullotave" janë shtuar fondet për vitin 2023 në shumën 27,000 mijë lekë, këto për investime për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga zjarret; për programin '09230' "Arsimi i Mesëm" janë shtuar fondet për paga e sigurime për një punonjës që do të shërbej në Qëndren Rinore, respektivisht; për vitin 2023-434 mijë lekë dhe për vitet 2024-2024 nga 869 mijë lekë; për programin '10430' "Përkujdesi Social" janë shtuar fondet për paga e sigurime për 5 punonjësit e projektit "Tungjatjeta Jetë", deri tani financiar pjesërisht nga MSHMS, por në vazhdim do të mbulohen tërësisht nga bashkia. Fondet e shtuara për vitet 2023-2025 janë nga 3,292 mijë lekë çdo vit. Për këto shtesa janë zvogluar fondet në programin "04520" "Rrjeti i rrugë rurale e urbane".

☞ Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të krijuara ndër vite, të parashikuarra për t'u likuiduar gjatë 3 vjeçarit, respektivisht për vitin 2023-61,077 mijë lekë, për vitin 2024-56,570 mijë lekë dhe për vitin 2025-51,000 mijë lekë, ku vlera gjithsej e likuidimit të detyrimeve për tre vitet është 168,647 mijë lekë. Në detyrimet e prapambetura peshën më të madhe e zënë shpronësimet e para vitit 2015 dhe detyrimet që kanë ardhur nga ish-komunat, ndërsa për vitet 2016-2021 trashëgohen detyrime minimale.

☞ Pësia e shpenzimeve kapitale dhe shërbimeve publike me burim financimi nga burimet e veta janë në rritje nga viti në vit, kjo për të mundur përmirësimin e shërbimeve dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

☞ Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore pësojnë rritje rreth 1.3-1.5 % ndër vite, kjo referuar vjetërsisë në punë dhe inflacionit.

☞ Shpenzimet e tjera dhe ato operative kanë pësuar rritje ndër vite, kjo për arsye të rritjes së fondeve për shërbimet sociale, ndërsa shpenzimet administrative vijnë në ulje nga viti në vit.

☞ Në përcaktimin e taveve të shpenzimeve një vëmendje e vecantë është treguar edhe në përcaktimin e shpenzimeve për nënprogramin e Mbrojtjes Civile, ku shpenzimet në këtë nënprogram zënë rreth 2.8-3 % të buxhetit nga burimet e bashkisë.

Si përfundim, në mënyrë të detajuar dhe analitike jepen Tavanet sipas Programeve Buxhetore, bashkëlidhur këtij projektvendimit.

Lezhë, më 14.07.2022

DREJTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT

**Brikena Vuksani**

TAVANET BUXHETORE PËR ÇDO PROGRAM PËR PBA-në 2023-2025 (Faza e II-të)

Nr. Kodi	Emërtimi	2023						2024			2025		
		600-601		602-606		230-231		600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231
<b>1</b>	<b>Programi 01110</b>	<b>111,093</b>	<b>69,125</b>	<b>3,300</b>	<b>113,236</b>	<b>60,905</b>	<b>3,300</b>	<b>115,411</b>	<b>61,040</b>	<b>3,300</b>	<b>115,411</b>	<b>61,040</b>	<b>3,300</b>
01110	Planifikim, menaxhim, admin.	69,964	57,414	3,000	71,369	57,513	3,000	72,796	57,620	3,000	72,796	57,620	3,000
01120	Çështje financiare dhe fiskale	32,484	3,365	300	33,132	3,392	300	33,795	3,420	300	33,795	3,420	300
01170	Gjendja Civile	8,645	0	0	8,735	0	0	8,820	0	0	8,820	0	0
01710	Pagesa shërbimit të borxhit	0	8,346	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>2</b>	<b>Programi 03140</b>	<b>10,895</b>	<b>6,217</b>	<b>0</b>	<b>11,004</b>	<b>6,304</b>	<b>0</b>	<b>11,114</b>	<b>6,396</b>	<b>0</b>	<b>11,114</b>	<b>6,396</b>	<b>0</b>
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	10,895	1,976	0	11,004	1,979	0	11,114	1,985	0	11,114	1,985	0
03600	Marrëdhëniet në Komunitet	0	4,241	0	0	4,325	0	0	4,411	0	0	4,411	0
<b>3</b>	<b>Programi 03280</b>	<b>43,192</b>	<b>31,233</b>	<b>10,050</b>	<b>44,051</b>	<b>31,202</b>	<b>0</b>	<b>44,539</b>	<b>31,300</b>	<b>0</b>	<b>44,539</b>	<b>31,300</b>	<b>0</b>
03280	Mbrojtja nga zjarri (MZSH)	37,888	4,099	10,050	38,645	4,056	0	39,031	4,097	0	39,031	4,097	0
03280	Mbrojtja civile (Em.Civile)	5,304	27,134	0	5,406	27,146	0	5,508	27,203	0	5,508	27,203	0
<b>4</b>	<b>Programi 04130</b>	<b>6,183</b>	<b>3,977</b>	<b>200</b>	<b>6,289</b>	<b>3,977</b>	<b>150,200</b>	<b>6,398</b>	<b>3,977</b>	<b>200</b>	<b>6,398</b>	<b>3,977</b>	<b>200</b>
04130	Mbështetja për zhvillim ekon.	1,666	220	0	1,682	220	0	1,699	220	0	1,699	220	0
04160	Shërbimi tregjeve, akred. insp.	0	0	0	0	0	150,000	0	0	0	0	0	0
04740	Projekte zhvillimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
04760	Zhvillimi i Turizmit	4,517	3,757	200	4,607	3,757	200	4,699	3,757	200	4,699	3,757	200
<b>5</b>	<b>Programi 04220</b>	<b>21,860</b>	<b>2,422</b>	<b>0</b>	<b>22,079</b>	<b>2,422</b>	<b>0</b>	<b>22,520</b>	<b>2,422</b>	<b>0</b>	<b>22,520</b>	<b>2,422</b>	<b>0</b>
04220	Shërb.bujqësore, inspek.siguria ushqimore,mb.konsumatorëve.	21,860	2,422	0	22,079	2,422	0	22,520	2,422	0	22,520	2,422	0
<b>6</b>	<b>Programi 04240</b>	<b>7,928</b>	<b>28,702</b>	<b>6,501</b>	<b>8,070</b>	<b>28,702</b>	<b>0</b>	<b>8,152</b>	<b>28,702</b>	<b>0</b>	<b>8,152</b>	<b>28,702</b>	<b>0</b>
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujtitjes dhe kullimit	7,928	28,702	6,501	8,070	28,702	0	8,152	28,702	0	8,152	28,702	0
<b>7</b>	<b>Programi 04260</b>	<b>13,061</b>	<b>1,024</b>	<b>28,368</b>	<b>13,296</b>	<b>1,024</b>	<b>1,516</b>	<b>13,429</b>	<b>1,024</b>	<b>1,516</b>	<b>13,429</b>	<b>1,024</b>	<b>2,676</b>
04260	Administ.pyjeve dhe kullotave	13,061	1,024	28,368	13,296	1,024	1,516	13,429	1,024	1,516	13,429	1,024	2,676
<b>8</b>	<b>Programi 04520</b>	<b>32,267</b>	<b>48,052</b>	<b>266,576</b>	<b>32,365</b>	<b>48,052</b>	<b>201,901</b>	<b>32,688</b>	<b>48,052</b>	<b>201,901</b>	<b>32,688</b>	<b>48,052</b>	<b>95,838</b>
04520	Rrjeti rrugor rural	32,267	48,052	266,576	32,365	48,052	201,901	32,688	48,052	201,901	32,688	48,052	95,838
<b>9</b>	<b>Programi 04570</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
04570	Transporti publik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>10</b>	<b>Programi 05100</b>	<b>26,400</b>	<b>82,419</b>	<b>0</b>	<b>26,660</b>	<b>82,419</b>	<b>0</b>	<b>26,930</b>	<b>82,419</b>	<b>0</b>	<b>26,930</b>	<b>82,419</b>	<b>40,000</b>
05100	Menaxhimi i mbejtjeve	26,400	82,419	0	26,660	82,419	0	26,930	82,419	0	26,930	82,419	40,000
05320	Prog.për mbrojtjen e mjedisit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>11</b>	<b>Programi 06140</b>	<b>15,670</b>	<b>1,755</b>	<b>0</b>	<b>15,826</b>	<b>1,755</b>	<b>0</b>	<b>16,143</b>	<b>1,755</b>	<b>0</b>	<b>16,143</b>	<b>1,755</b>	<b>0</b>

Në mijë lekë

06140	Planifikimi Urban Vendor	15,670	1,755	0	15,826	1,755	0	16,143	1,755	0
06210	Programet e Zhvillimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>12</b>	<b>Programi 06260</b>	<b>37,530</b>	<b>29,539</b>	<b>1,500</b>	<b>37,587</b>	<b>29,653</b>	<b>1,500</b>	<b>38,281</b>	<b>29,767</b>	<b>1,500</b>
06260	Shërbimet publike vendore	31,857	16,278	1,500	31,857	16,392	1,500	32,494	16,506	1,500
06440	Ndriçim rrugësh	5,673	13,261	0	5,730	13,261	0	5,787	13,261	0
<b>13</b>	<b>Programi 06370</b>	<b>6,928</b>	<b>4,968</b>	<b>200,086</b>	<b>7,066</b>	<b>5,066</b>	<b>262,584</b>	<b>7,208</b>	<b>5,167</b>	<b>210,000</b>
06330	Furnizimi me ujë	0	0	200,086	0	0	262,584	0	0	210,000
05200	Menaxhimi i U.Z Kanalizime	6,928	4,968	0	7,066	5,066	0	7,208	5,167	0
<b>14</b>	<b>Programi 07220</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>15</b>	<b>Programi 08130</b>	<b>2,349</b>	<b>14,906</b>	<b>0</b>	<b>2,419</b>	<b>15,354</b>	<b>64,463</b>	<b>2,467</b>	<b>15,661</b>	<b>25,576</b>
08130	Sport dhe Argëtim	2,349	14,906	0	2,419	15,354	64,463	2,467	15,661	25,576
<b>16</b>	<b>Programi 08220</b>	<b>18,978</b>	<b>3,540</b>	<b>16,258</b>	<b>19,053</b>	<b>3,603</b>	<b>36,500</b>	<b>19,243</b>	<b>3,639</b>	<b>0</b>
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	18,978	3,540	16,258	19,053	3,603	36,500	19,243	3,639	0
<b>17</b>	<b>Programi 09120</b>	<b>147,941</b>	<b>49,510</b>	<b>43,155</b>	<b>150,200</b>	<b>47,987</b>	<b>0</b>	<b>152,493</b>	<b>47,987</b>	<b>85,260</b>
09120	Arsimi parashkollor dhe bazë	147,941	49,510	43,155	150,200	47,987	0	152,493	47,987	85,260
<b>18</b>	<b>Programi 09230</b>	<b>28,615</b>	<b>18,358</b>	<b>510</b>	<b>29,550</b>	<b>19,939</b>	<b>308</b>	<b>30,060</b>	<b>20,693</b>	<b>25,308</b>
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	19,349	6,990	202	20,120	7,194	0	20,463	7,404	25,000
09240	Arsimi profesional	9,266	11,368	308	9,430	12,745	308	9,597	13,289	308
<b>19</b>	<b>Programi 10430</b>	<b>30,750</b>	<b>630,042</b>	<b>20,200</b>	<b>30,826</b>	<b>655,190</b>	<b>200</b>	<b>30,902</b>	<b>678,492</b>	<b>200,200</b>
10140	Kujdesi social për PAK	9,270	504,292	0	9,302	529,440	0	9,334	550,742	200,000
10220	Sigurimi shoqëror	0	250	20,000	0	250	0	0	250	0
10430	Kujdesi social familje e fëmijët	21,480	125,500	200	21,524	125,500	200	21,568	127,500	200
10550	Papunësia, arsimit dhe aftësim	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>20</b>	<b>Programi 10661</b>	<b>829</b>	<b>5,021</b>	<b>0</b>	<b>833</b>	<b>5,021</b>	<b>0</b>	<b>837</b>	<b>5,021</b>	<b>0</b>
10661	Strehim Social	829	5,021	0	833	5,021	0	837	5,021	0
<b>TOTALI TAVANEVE</b>		<b>562,469</b>	<b>1,030,810</b>	<b>596,704</b>	<b>570,410</b>	<b>1,048,575</b>	<b>722,472</b>	<b>578,815</b>	<b>1,073,514</b>	<b>689,858</b>
04910	Fondi Rezervë	0	6,838	0	0	7,736	0	0	8,100	0
04940	Fondi i Kontigjencës	0	6,839	0	0	7,737	0	0	8,100	0
<b>T O T A L I</b>		<b>562,469</b>	<b>1,044,487</b>	<b>596,704</b>	<b>570,410</b>	<b>1,064,048</b>	<b>722,472</b>	<b>578,815</b>	<b>1,089,714</b>	<b>689,858</b>
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>				<b>2,203,660</b>			<b>2,356,930</b>			<b>2,358,387</b>



Këshilli

Nr. 13469/ prot  
d. 08.08.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 549/5 Prot.

Lezhë, më 04.08.2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 85, datë 28.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2023-2025 (faza e dytë) të Bashkisë Lezhë”.

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**

